

Në datë 23.05.2018, ora 10:22:18, përdoruesi i numrit telefonik 068 56 92 692 (i dyshuari Albert Veliu) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 069 53 66 327 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: "...+692: Sa të vi djali të vëni direkt për azil politik. +327: Mirë mirë mirë. +692: Aty ambjenti mirë duket? +327: Mirë o Berti aman të keqen jemi brenda..."

Në datë 27.05.2018, ora 21:17:08, përdoruesi i numrit telefonik 069 94 23 771 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: "...+091: Ej po se, po s'foli me ty nuk flas me asnjëri në botë, dëgjo mua. +771: Po. +091: Më është afruar një gjë e mirë nga një pala tjetër e kupton tani muhabetin. +771: Po. +091: Janë të gjitha, unë i kam me... e ke parasysh?".

Në datë 28.05.2018, ora 12:32 përdoruesi i nr. të tel. 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i nr. të tel. 068 20 29 700 dhe bëjnë këtë bisedë veç të tjerash: 700- Ej e more vesh? 091-He? 700-I arrestun ne Kosove ato shokun tend me djalin.....

Në datë 28.05.2018, ora 19:42:36, përdoruesi i numrit telefonik 068 20 29 700 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: "...+700: Ej nuk e kam problem unë se ky shoku jonë që ishte sot ky ky i vje keq pak. +091: O vllai i thashë, o Salë i thashë unë ca të jenë i thashë unë ndajme të tre, në rregull në rregull po pse t'i lëmë kështu i ...motrën. ai duhet ta ulë në tavolinë e di si është muhabeti t'ja jap me...e ke parasysh ti?".

Në datë 29.05.2018, ora 17:17:22, përdoruesi i numrit telefonik 068 20 29 700 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: "...+700: Edhe tha hajde tha, thuj Fredi hajd ta takojmë e të shkoj ta takoj vetë atë me dur të lidhme, ti thojmë o kshu o të fillojmë në krahin tjetër. +091: Po në rregull në rregull. +700: Më mirë kshu më mirë kshu tha Saliu, shkoj unë e takoj. +091: O vlla unë ju kam vllazër e unë. +700: E di Fredi, Fredi jemi shokë ne jemi shokë po shko tako Salium e shkoni, tako atë".

Në datë 29.05.2018, ora 21:00:02, përdoruesi i numrit telefonik 069 20 62 000 (i rezultuar gjatë bisedës si Shkëlzen Breçani) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 (i rezultuar në tërësinë e bisedave të përgjuara si Fredi Alizoti) dhe, gjatë bisedës u fol: për premtimin që duhej të mbante dikush që e kishte dhënë ai: "...+000: ...unë nuk kam dit gjo fare, as u kam thon hajdeni as hiç, por ai që ju ka premtue, ça u ka than, duhet t'u rri tek kamit e me ja marr. +091: Nuk kemi marrë asgjë akoma, po do llafosemi, do pimë kafe dhe do të sqaroj unë...+091: Jo me se me premtun diçka ktu, prit, eee e kupton ti..."; për dijeninë e Fredit rreth të dhënave që me shumë gjasa kanë lidhje me çështjen: "...+091: Çunat po e mbajnë nga brenda se thesin e kam unë, po ta hap unë thesin mbaron çdo gjë...e kupton vetë ti muhabetin..."; për vlerësimin nga Shkëlzeni si gabim, nëse gjithçka ishte organizua për të përfutuar para: "+000: Në qoftë se i ka hy për lek, ka bo gabimin më të madh, e mo, o shoku jem, po ça boni o burr..."; për qënien e gjithçkaje të trilluar, të stisur, të pohuar si të tillë nga Fredi: "...+091: ...unë prap po